

V E N D I M
Nr.486, datë 21.10.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.76, DATË
11.2.1999 "PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA
SHTETËRORE DHE TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE
SHËRBIMEVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.76, datë 11.2.1999 "Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe trajtimin me pagë të efektivave të këtyre shërbimeve" ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.220, datë 10.5.1999 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.294, datë 24.6.1999 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 8 ndryshon dhe formulohet si vijon:

"Trajtimi me pagë bazë mujore i efektivit të Degës së Ruajtjes e Shoqërimit të Personaliteteve të Larta Shtetërore, bëhet sipas klasave të njëjtë me funksionet e tjera analoge në polici dhe me shtesë për vështirësi shërbimi":

a) Për funksionet që merren drejtpërsëdrejti me ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore, në masën deri në 350 për qind:

b) Për funksionet e tjera që shërbejnë në këtë repart, në masën deri 20 për qind më të lartë se funksionet analoge, që shërbejnë në strukturat e tjera të Ministrisë së Rendit Publik.

c) Efektivi i kësaj dege përfiton edhe çdo trajtim tjetër si të gjithë ushtarakët e sistemit të Rendit Publik, me përjashtim të pagesave për mbikohë pune e shërbimi.

Klasifikimi i funksioneve organike për efekt të caktimit të pagës bazë dhe shtesat për vështirësi shërbimi për çdo funksion përcaktohen nga Ministri i Rendit Publik.

2. Pikat 9, 10 dhe paragrafi i parë i pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.76, datë 11.2.1999 me ndryshimet përkatëse shfuqizohen.

3. Efektet financiare përballohen nga fondet e Ministrisë së Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko